



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT

**BURSA STUDIMI NË PROGRAMIN E BURSAVE “HEYDAR ALIYEV  
INTERNATIONAL EDUKATION GRANT PROGRAM”  
VITI AKADEMIK 2026 - 2027**

Republika e Azerbajxhanit, në kuadër të “Programit të granteve studimore për shtetasit e vendeve anëtare të Organizatës për Bashkim Islamik (OBI)” për vitin akademik 2026-2027 ka shpallur programin e bursave studimore për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të studiojnë në programe të plota studimi Bachelor, Master dhe Doktoraturë pranë universiteteve shtetërore të Azerbajxhanit.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi deri më datë 15.04.2026 duhet të dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dokumentet përkatëse sipas informacionit bashkëlidhur.

Dokumentacioni duhet të shoqërohet me kërkesën e firmosur nga kandidati drejtuar MA (ku të jepet një adresë kontakti e-mail dhe numër telefoni), duke specifikuar fushën e studimit në të cilën dëshiron të studiojë kandidati.

Afatet kryesore

- Dorëzimi i aplikimeve (faza e parë): 16 shkurt – 15 prill 2026
- Regjistrimi online në sistemin SIACAS (faza e dytë): 18 maj – 1 qershor 2026
- Shpallja e kandidatëve të përzgjedhur: korrik – gusht 2026
- Fillimi i vitit akademik: 15 shtator 2026

Kriteret kryesore

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriterin e moshë sipas programit;
- Mosha maksimale:
  - o deri 35 vjeç për programet Bachelor;
  - o deri 40 vjeç për programet Master dhe rezidencë mjekësore;
  - o deri 45 vjeç për programet PhD;

Dokumentet e kërkuara

- Formulari i aplikimit;
- Kopje e diplomave dhe listës së notave;
- CV;



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT**

- Kopje e pasaportës;
- Certifikatë mjekësore;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së studimit;
- Letër motivimi.

Bursa mbulon shpenzimet e ushqimit, të akomodimit, tarifën e shkollimit dhe të regjistrimit, shpenzimet për një biletë udhëtimi vajtje ardhje me avion gjatë periudhës së studimeve dhe siguracionin shëndetësor.

Për informacion më të detajuar, për formularët e aplikimit dhe të përgatitjes së dokumentacionit të kërkuar, ju lutemi referohuni informacionit që gjendet në faqen e internetit të Ministrisë së Shkencës dhe Arsimit të Republikës së Azerbajxhanit në link:

<https://studyinazerbaijan.edu.az/financial-support>

[https://studyinazerbaijan.edu.az/H.Aliyev\\_IEG\\_CALL\\_18.04.pdf](https://studyinazerbaijan.edu.az/H.Aliyev_IEG_CALL_18.04.pdf)

**DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE DHE PROJEKTEVE**